

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shumë gra po e ngatërrojnë këtë infeksion seksual me dhimbjet e ciklit
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/28/shume-gra-po-e-ngaterrojne-kete-infeksion-seksual-me-dhimbjet-e-ciklit/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:02:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:59:56 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f1f4239dddc3483f64f5b52ca5fca73d70f378ba2b3d59dc9f006029c4e96e69
TEKSTI	d884e25e1b26bfc0a66db54f8d169df37a78358d4f8884299f3279c5f1ca3e80
PAMJA	f819842c5901f54d6fd83c6b75603308ae1b09497a2df775fb93da4864602c54

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	02b784ec65bb96ed1c2d76542df4cc70dd6be64b963891cbc964fcc6b8bf31aa
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcec101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/02b784ec65bb96ed1c2d76542df4cc70dd6be64b963891cbc964fcc6b8bf31aa>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > SHENDETI

Shumë gra po e ngatërrojnë këtë infeksion seksual me dhimbjet e ciklit

17:59 : 28/09/2026 në SHENDETI



Dhimbjet menstruale janë diçka që shumë gra janë mësuar t'i konsiderojnë pjesë normale të ciklit, edhe pse shpesh mund të jenë të pakëndshme.

Por sipas Dr. Asiya Maula, mjeke e përgjithshme në The Health Suite në Leicester, jo çdo dhimbje në fund të barkut apo gjakderdhje mes cikleve duhet t'i atribuohet menstruacioneve.

Në disa raste, shkak mund të jetë klamidia, një nga infeksionet seksualisht të transmetueshme më të diagnostikuara.

“Problemi me klamidian është se shpesh nuk jep shenja të qarta”, shpjegon Dr. Maula. Sipas saj, disa paciente paraqiten me dhimbje menstruale më të forta ose më të zgjatura se zakonisht, apo me gjakderdhje të lehtë mes cikleve, simptoma me të cilat mund të jenë mësuar të jetojnë.

“Në shumicën e rasteve nuk bëhet fjalë për diçka serioze. Por herë pas here shkak është klamidia dhe pacientet nuk e dinë fare”, thotë ajo.

Lexo edhe:

[Ankthi social ndryshon mënyrën si truri mëson kur dikush të vëzhgon](#)

[Stresi dhe inflamacioni mund të dëmtojnë zemrën në heshtje](#)

Simptomat mund të jenë shumë të lehta

Klamidia shpesh nuk shkakton simptoma.

Edhe kur shenjat shfaqen, ato mund të jenë të lehta dhe të ngatërrohen me infeksion urinar, stres ose probleme të tjera të zakonshme.

Për më tepër, simptomat mund të shfaqen dhe të zhduken, gjë që e bën infeksionin edhe më të vështirë për t'u dalluar.

TË GJITHA



Shumë gra po e ngatërrojnë këtë infeksion seksual me dhimbjet e ciklit

17:59 : 28/09/2026



Këshilli i Sigurisë përforcon alibin e Ramës për Vlorë Hysenin

17:53 : 28/09/2026



Përplasja për rregulloren, GJKKO në kolaps, 3 javë pa gjyqe

17:38 : 28/09/2026



Vokshi: Integrimi në BE nuk është vetëm mbyllja e kapitujve

17:24 : 28/09/2026



Kosovë/ Partitë ende pa marrëveshje për presidentin e ri

17:10 : 28/09/2026



Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov kërcënon Europën: Lufta me ju do jetë shumë e shkurtër

16:57 : 28/09/2026



Zjarri i madh në Pogradec, flakët drejt masivit me pisha

16:50 : 28/09/2026

Sipas Dr. Maula, shumë njerëz mendojnë se gjithçka është në rregull nëse dhimbja ose shqetësimi kalon pas disa ditësh.

Por infeksioni mund të vazhdojë të jetë i pranishëm edhe kur simptomat largohen.

Kjo është veçanërisht shqetësuese sepse klamidia e patrajtuar mund të çojë në sëmundje inflamatore të legenit, e njohur si PID.

Kjo gjendje është një nga shkaqet e parandalueshme të infertilitetit dhe mund të rrisë gjithashtu rrezikun për shtatzëni jashtë mitrës.

Edhe PID mund të zhvillohet pa simptoma të dukshme.

Disa gra mund të mos e kuptojnë se kanë pasur problem deri pas disa vitesh, kur përpiqen të mbeten shtatzënë dhe hasin vështirësi.

Jo çdo dhimbje cikli është arsye për alarm

Megjithatë, ekspertët theksojnë se kjo nuk do të thotë se çdo dhimbje menstruale duhet të ngrejë dyshime për një infektion seksualisht të transmetueshëm.

Dhimbjet e ciklit janë shumë të zakonshme dhe mund të kenë një sërë shkaqesh që nuk lidhen me infeksionet seksualisht të transmetueshme.

Qëllimi, sipas mjekes, është që njerëzit të dinë kur një dhimbje nuk duket më si dhimbje tipike menstruale.

Nëse simptomat janë të pazakonta, zgjasin më shumë se zakonisht ose shoqërohen me gjakderdhje mes cikleve, sekrecione jo normale ose shqetësime gjatë urinimit, kontrolli mjekësor është i këshillueshëm.

Cilat janë simptomat e klamidias?

Kontrollet e rregullta për infeksionet seksualisht të transmetueshme janë të rëndësishme, sepse klamidia mund të mos japë simptoma në një pjesë të madhe të rasteve.

Kur simptomat shfaqen, ato zakonisht paraqiten nga rreth një javë deri në një muaj pas infektimit.

Te gratë, shenjat mund të përfshijnë:

sekrecione vaginale të pazakonta;
gjakderdhje pas marrëdhënieve seksuale ose mes cikleve;
djegie gjatë urinimit;
dhimbje në pjesën e poshtme të barkut;
dhimbje gjatë marrëdhënieve seksuale;
gjakderdhje pas marrëdhënieve.

Te burrat, simptomat mund të përfshijnë:

sekrecione të bardha, të turbullta ose ujore nga penisi;
djegie ose kuarje rreth penisit dhe testikujve;
ënjtje ose dhimbje të testikujve;
ndjesi djegieje gjatë urinimit.

Klamidia mund të prekë edhe pjesë të tjera të trupit që kanë pasur kontakt seksual.

Për këtë arsye, mund të shfaqen edhe simptoma si dhimbje, gjakderdhje ose sekrecione anale, dhimbje fytë apo skuqe, dhimbje dhe sekrecione nga sytë.

Trajtohet lehtësisht me antibiotikë

Nëse ekziston dyshimi për klamidia, sidomos pas marrëdhënieve seksuale pa mbrojtje, rekomandohet kryerja e një testi.

Klamidia zakonisht trajtohet në mënyrë efektive me antibiotikë.

Sa më herët të diagnostikohet dhe trajtohet, aq më i ulët është rreziku për komplikime afatgjata.

Lajme të lidhura



Ankthi social ndryshon mënyrën si truri mëson kur dikush të vëzhgon

18:05 : 24/09/2026



Stresi dhe inflamacioni mund të dëmtojnë zemrën në heshtje

20:17 : 23/09/2026



Teknologjia po ndryshon restorantet, si do të ushqehemi në të ardhmen?

19:48 : 18/09/2026



Onkologu zbulon 5 gjërat që nuk i bën kurrë në shtëpi

19:00 : 18/09/2026



Moti i ftohtë mund të paralajmërojë rritjen e rasteve të arrestit kardiak

20:03 : 17/09/2026



Gërhitja e partnerit nuk është thjesht bezdi, mund t'ju dëmtojë seriozisht shëndetin

09:56 : 11/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.